



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 2040 Prot.

Vau Dejes me 29.04 .2024

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Karmë, Njesia Administrative Vau Dejës të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtëm:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9(nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.1053 ha “Për qëllime shëndetësore,shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojërash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)në ngastren nr. 6 , ekonomia pyjore Karmë” .

(Paraqitur nga Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **08.05.2024 ora 10.30 fshati Karmë**, Njësia Administrative Vau Djës.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës për projekt vendimin e mësipërm,nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al, facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI I KËSHILLIT

Ardian CELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SE
MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE

Nr. 1811 prot.

Vau Dejës, më 02, 04, 2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Z. Ervis Shimaj
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar Z. Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin "Për dhënien në përdorim me afat deri në 9 (nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.1053 ha për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shplothëse, kulturore, etj), në ngastrën nr.6, ekonominë pyjore Karmë." dhe relacionin shoqërues.

Me respekt,

KRYETARI
Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Gjovalin ZEFI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SE
MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE

PROJEKT V E N D I M

Nr. 16, datë 02.04.2024

“Për dhënien në përdorim me afat deri në 9 (nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.1053 ha për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)`, në ngastrën nr.6, ekonominë pyjore Karmë.”

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2 germa “a”, nenit 27 pika 5, nenit 54 germa “e/l”, nenit 55 pika 3, nenit 18, neni 64 germa “c” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenin 25 germa “a” të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar; pikën 49, shtojca 47, të VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar; Kreun II pika 3, Kreun III pika 5 të VKM-së nr. 748, datë 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”; shtojcën nr.1 pika 6/3 të VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”; VKB-në Vau Dejës nr. 7 dt. 26.01.2024 “Mbi miratimin e listës së ngastrave/ nënngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”; Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, ku në mbledhjen e datës _____ 2024 të:

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 0.1053 ha për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)`, në ngastrën nr.6, ekonominë pyjore Karmë, sipas hartës topografike, relacionit dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik bashkëngjitur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Afati i dhënies në përdorim të jetë deri në 9 (nëntë) vjet.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar.për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, shtojca nr.1 pika 6/3.
4. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Gjovani Zefi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SE
MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE

Nr. _____ prot.

Vau Dejës, më 02 . 04 .2024

RELACION

“Për dhënien në përdorim me afat deri në 9 (nëntë) vjet të sipërfaqes pyjore prej 0.1053 ha për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)`, në ngastrën nr.6, ekonominë pyjore Karmë.”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 pika 5 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përcaktohet:

“Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit: Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

... 5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.”

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në nenin 9 pika 1.2 germa “a”, nenit 54 germa “e/l”, nenit 55 pika 3, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë, dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Sipërfaqja e fondit pyjor që kërkohet të jepet në përdorim është **0.1053 ha**. Kjo sipërfaqje do t’i nënshtrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Procedura e ndjekur është në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik.”.

Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas shtojcën nr.1 pika 6/3 të VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”,
si më poshtë:

6. Për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj.				
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqia e përdorur në Ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit	
			1 vit	2- 5 vjet
1	Pyll Trungishte	198000	132825	110000
2	Pyll cungishte	138600	99000	82500
3	Pyll shkurre	138600	99000	82500
4	Kullota	138600	99000	82500
5	Tokë me Bimësi pyjore, djerr	99000	57200	49500
6	Inproduktive	99000	57200	49500

Afati i dhënies me qira do të jetë deri në 9 (nëntë) vjet.

1. Vlera totale e pagesës/vit sipas raportit teknik-ekonomik, do të jetë 8 687 (Tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë në vit.

Duke u mbështetur në Kreun III pika 5 e VKM-së nr. 748, datë 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”, që parashikon: **“Në liqene, rezervuarë, pellgje me ujë, natyrorë apo artificialë, laguna, zona dhe gjersia e bregut është hapësira tokësore e krijuar nga vija ujore tek vija e krijuar nga gjurma e lënë nga uji në vite gjatë niveleve maksimale në të gjithë perimetrin e trupit ujqor.”** dhe referuar koordinatave të pasqyruara në hartën topografike, rezulton se sipërfaqja që do të jepet në përdorim **ndodhet jashtë bregut**. Koordinatat që pasqyrojnë “brigjet” dhe “sipërfaqen që do të jepet në përdorim” paraqiten në hartën nr. 1 (bashkëlidhur). Kështu krahasojmë sipas legjendës së hartës.

Bazuar në sa mësipër, propozojmë mīratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **0.1053 ha**, për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi, kampingje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj) në ngastrën nr.6, ekonominë pyjore Karmë.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin e plotë, hartën e ekonomisë, hartën topografike, raportit mbi studimin tekniko-ekonomik.

Duke ju falenderuar, ju ftojmë në miratimin e projekt-vendimit.

Grupi i Punës

Ing. Mark SULLI

Ing. Zeqir UJKA

**Miratoi
Drejtori
Vehbi SHKJAU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Vau Dejës

Shtojca nr. 1

RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS PËR QËLLIME SHËNDETËSORE, SHOQËRORE, TURISTIKE, SPORTIVE, KULTURORE, PUSHIMI DHE ARGËTIMI (KAMPINGJE, KËNDE LOJRASH, MJEDISE SPORTIVE, SHPLODHËSE, KULTURORE, ETJ.).

Bazuar në Urdhërin nr.36, datë 16.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira, z. Zeqir Ujka Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve, z. Mark Suli Specialist i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve, nga data **28/02/2024** deri në datën **29/02/2024** studjuan dhe realizuan verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral, për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **0.1053** ha për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj.).

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullor sipas VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar, rezulton që sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim është **0.1053** ha për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj.) dhe bën pjesë në **ngastrën nr.6**, ekonomia pyjore **Karmë**, sipas listës së inventarit, pikës 49, shtojca 47, janë në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas hartës topografike, tabelave përkatëse bashkëlidhur)*.

Duke u mbështetur në Kreun III pika 5 e VKM-së nr. 748, datë 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”, që parashikon: “**Në liqene, rezervuarë, pellgje me ujë, natyrorë apo artificialë, laguna, zona dhe gjersia e bregut është hapësira tokësore e krijuar nga vija ujore tek vija e krijuar nga gjurma e lënë nga uji në vite gjatë niveleve maksimale në të gjithë perimetrin e trupit ujqor.**” dhe referuar koordinatave të pasqyruara në hartën topografike, rezulton se sipërfaqja që do të jepet në përdorim **ndodhet jashtë bregut**. Koordinatat që pasqyrojnë “brigjet” dhe “sipërfaqen që do të jepet në përdorim” paraqiten në hartën nr. 1 *(bashkëlidhur)*. Kështu krahasojmë sipas legjendës së hartës.

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur, jepen në përdorim deri në 9 (nëntë) vjet një sipërfaqe prej **0.1053** ha për qëllime shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive, kulturore, pushimi dhe argëtimi (kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj.).

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi pyjqor janë të mbështetura në ligjin nr. 57 datë 30.04.2020 “Për pyjet” i ndryshuar, VKM-së nr. 748, datë 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”; ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjqor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjqore”, Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjqor dhe kullësor publik.”.

Sipërfaqja që do të jepet në përdorim do t’i nënshtrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi. Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, Kryetari i Bashkisë nxjerr urdhërin për zhvillimin e procedurës së konkurimit publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas shtojcën nr.1 pika 6/3 të VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

Shuma në lekë/vit konsiston në:

Vlerën e përdorimit leke/ha/vit për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj.).

1. Ngastra nr .6 shkurre **0.1053 ha x 82 500 lekë = 8 687** (Tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë në vit.

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing.Zeqir Ujka

Ing. Mark Suli

Konfirmoi:

KRYETARI

KRISTIAN SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/ KRYETARI

GJOVALIN ZEEI



PLAN RILEVIMI

PERGATITI:

Data Pergatitjes: 06.03.2024

SIPERFAQE

S= 0.1053 Ha

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE KARME

NR.PASURISE 6 VOL FQ

SHKALLA 1:10000


INDEKSI I HARTES Ekonomia PYJORE KARME

ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER F:

POROSITES : BASHKIA VAU DEJES



SISTEMI I KOORDINATAVE: GAUS KRYGER



KOORDINATAT E KONTURIT:

- | | | | |
|---------------------------|---------------------------|---------------------------|---------------------------|
| 1) 4660052.4
4394301.4 | 2) 4660039.2
4394323.2 | 3) 4660005.4
4394298.8 | 4) 4660020.7
4394275.0 |
| 5) 4660042.5
4394293.3 | 6) 4660038.5
4394297.2 | 7) 4660045.4
4394303.3 | 8) 4660049.4
4394299.3 |

Mug. Mark Suli

Mug. Dep. Zyga